



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 116

Tiranë – E premte, 5 qershor 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 48/2026, datë 8.5.2026	Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 2, me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Malit të Zi dhe Komisionit Evropian për Programin IPA të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi–Shqipëri 2021–2027, ratifikuar me ligjin nr. 9/2024.....
	10687
Dekret i Presidentit nr. 332, datë 1.6.2026	Për shpallje ligji.....
	10697
Ligj nr. 49/2026, datë 8.5.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar.....
	10697
Dekret i Presidentit nr. 333, datë 1.6.2026	Për shpallje ligji.....
	10698
Ligj nr. 50/2026, datë 8.5.2026	Për disa ndryshime në ligjin nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”
	10698
Dekret i Presidentit nr. 334, datë 1.6.2026	Për shpallje ligji.....
	10699
Vendim i Kuvendit nr. 67/2026, datë 7.5.2026	Për mosmiratimin e kërkesës për zhvillimin e një interpelance urgjente
	10699
Vendim i Kuvendit nr. 81/2026, datë 14.5.2026	Për mosmiratimin e kërkesës për zhvillimin e një interpelance urgjente
	10699
Vendim i Kuvendit nr. 83/2026, datë 21.5.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, “Për miratimin e rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.....
	10700
Vendim i Kuvendit nr. 84/2026, datë 21.5.2026	Për ngritjen e nënkomisionit për administratën publike.....
	10706

Dekret i Presidentit nr. 336, datë 1.6.2026	Për lirim ambasadori nga detyra.....	10707
Dekret i Presidentit nr. 337, datë 1.6.2026	Për lirim ambasadori nga detyra.....	10707
Dekret i Presidentit nr. 338, datë 1.6.2026	Për lirim ambasadori nga detyra.....	10707
Dekret i Presidentit nr. 339, datë 1.6.2026	Për emërim ambasadori në detyrë.....	10708
Dekret i Presidentit nr. 340, datë 1.6.2026	Për emërim ambasadori në detyrë.....	10708
Dekret i Presidentit nr. 341, datë 1.6.2026	Për emërim ambasadori në detyrë.....	10708
Dekret i Presidentit nr. 342, datë 1.6.2026	Për emërim ambasadori në detyrë.....	10709
Dekret i Presidentit nr. 343, datë 1.6.2026	Për emërim ambasadori në detyrë.....	10709
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 300, datë 2.6.2026	Për delegimin/autorizimin e kompetencave të ministrit të Drejtësisë për nënshkrimin e dokumentacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror” te zëvendësministri.....	10709
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe Gazit nr. 29, datë 30.5.2026	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	10710
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe Gazit nr. 30, datë 2.6.2026	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	10711
Vendim i Bordit të Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe Gazit nr. 31, datë 4.6.2026	Për miratimin e çmimit tavan të tregtimit me shumicë/pakicë të nënprodukteve të naftës dhe të gazit.....	10712



LIGJ
Nr. 48/2026

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE NR. 2, ME SHKËMBIM
LETRASH, TË MARRËVESHJES SË
FINANCIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA
KËSHILLI I MINISTRAVE I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, MALIT
TË ZI DHE KOMISIONIT EVROPIAN
PËR PROGRAMIN IPA TË
BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
MALI I ZI-SHQIPËRI 2021–2027,
RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 9/2024

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese nr. 2, me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së financimit

ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Malit të Zi dhe Komisionit Evropian për programin IPA të bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi-Shqipëri 2021 – 2 027, ratifikuar me ligjin nr. 9/2024, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 8.5.2026.

Shpallur me dekretin nr. 332, datë 1.6.2026,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.



KOMISIONI EVROPIAN
ZGJERIMI DHE FQINJËSIA LINDORE

B – Ballkani Perëndimor

Drejtori

Bruksel, 21.10.2025

Lënda: Ndryshimi nr. 2 i Marrëveshjes së Financimit nëpërmjet Shkëmbimit të Letrave për programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi – Shqipëri për periudhën 2021–2027

Znj. Maida Gorcevic
Koordinatorë Kombëtare e IPA-s
Ministre
Ministria e Çështjeve Evropiane
Bulevardi Ivana Cmojevica 167
81 000 Podgoricë, Mali i Zi
E-mail: maida.gorcevic@mep.gov.me

Znj. Eridana Çano
Koordinatorë Kombëtare e IPA-s
Drejtorë e Përgjithshme,
Agjencia Shtetërore e Programimit
Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
Rruga “Kuvajt”
Tiranë, Shqipëri
Email: Eridana.Cano@saspac.gov.al

E nderuar ministre Gorçeviç,

E nderuar Znj. Çano,

Komisioni, Mali i Zi dhe Republika e Shqipërisë kanë lidhur një Marrëveshje Financimi për “Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi – Shqipëri për 2021–2027” më 14 nëntor 2023 (në vijim e referuar si “Marrëveshja e Financimit”).

Në përputhje me nenin 1(2) të Kushteve të Veçanta të Marrëveshjes së Financimit, qëllimi i këtij Ndryshimi është miratimi i angazhimit financiar në shumën 5,100,000 Euro për vitin 2025 (kontributi i BE-së), siç specifikohet në Shtojcën 1.

Në përputhje me nenin 2(1) të Kushteve të Veçanta, periudha e zbatimit të Marrëveshjes së Financimit për ndarjen buxhetore të vitit 2025 përcaktohet në 12 vjet nga data e hyrjes në fuqi të këtij ndryshimi nëpërmjet shkëmbimit të letrave.

Në përputhje me nenin 2(2) të Kushteve të Veçanta, periudha e zbatimit operacional për ndarjen buxhetore të vitit 2025 caktohet në 6 vjet nga data e hyrjes në fuqi të këtij ndryshimi nëpërmjet shkëmbimit të letrave.



Në lidhje me nenin 1(2) të Kushteve të Veçanta të Marrëveshjes së Financimit, qëllimi i këtij ndryshimi është thjeshtimi i miratimit të ndarjeve buxhetore të ardhshme, duke ndryshuar nenin 1(2), në mënyrë që të kalohet nga shkëmbimi i letrave ndërmjet Komisionit dhe përfituesve të IPA III në njoftimin me shkrim nga Komisioni për përfituesit e IPA III në lidhje me miratimin e angazhimeve vjetore të mëvonshme të buxhetit.

Ndryshimi i mëposhtëm i Marrëveshjes së Financimit çmohet i nevojshëm:

1. Neni 1(1) i Kushteve të Veçanta të Marrëveshjes së Financimit do të zëvendësohet me sa vijon:

“Neni 1

- (1) Bashkimi pranon të financojë dhe përfituesit e IPA III pranojnë financimin e Programit të mëposhtëm të Bashkëpunimit Ndërkufitar, siç përshkruhet në Shtojcën I:

Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi – Shqipëri për 2021–2027
Numri(at) i/e angazhimit global: ACT-60806
Për vitin 2022: JAD.976622
Për vitin 2025: JAG.SUM.2094421

Ky Program i Bashkëpunimit Ndërkufitar financohet nga buxheti i Bashkimit sipas aktit themelor të mëposhtëm: Instrumenti për Ndihmë Para-Aderimi (IPA III).

- (2) Kostoja totale e parashikuar e këtij Programi të Bashkëpunimit Ndërkufitar është 13,790,000 Euro dhe kontributi maksimal i Bashkimit për këtë Program është caktuar në 11,900,000 Euro.

Ky kontribut i Bashkimit do të ndahet në angazhime vjetore për periudhën 2022, 2025 dhe 2027 në përputhje me Aneksin I. Asgjë në këtë Marrëveshje Financimi nuk mund të interpretohet se nënkupton një angazhim financiar të Bashkimit lidhur me kreditë që ende nuk janë miratuar me miratimin e buxhetit të BE-së. Komisioni do të informojë me shkrim përfituesit e IPA III mbi miratimin e angazhimeve financiare të mëtejshme të përcaktuara në Aneksin I.

Nuk kërkohet asnjë kontribut financiar nga përfituesit e IPA III”.

Të gjitha dispozitat e tjera të Marrëveshjes së Financimit mbeten të pandryshuara.



Lutemi t'i përgjigjeni kësaj letre, duke shprehur miratimin tuaj mbi ndryshimet e shpjeguara më sipër, duke përdorur modelin e letrës së përgjigjes në Shtojcën 1.

Ky Shkëmbim Letrash do të përbëjë Ndryshimin nr. 2 të Marrëveshjes së Financimit, i cili do të hyjë në fuqi në datën e fundit të nënshkrimit të letrave, pas përfundimit të procedurave të brendshme ligjore të përfituesve të IPA III, të cilët pranojnë ndryshimin nga dy përfituesit e IPA III. Komisioni do të njoftojë përfituesit e IPA III për datën e hyrjes në fuqi, e cila nuk do të jetë më vonë se 31 dhjetor 2026.

Në pritje të marrjes së përgjigjeve tuaja mbi dakordësimin e këtij ndryshimi.

Sinqerisht,

Nënshkrimi

Valentina SUPERTI

Bashkëlidhur: Shtojca 1, Letër përgjigje e pranimit të ndryshimit.

Për dënim:

- Milica Adžić, Sekretare Shteti dhe Zyrtare Kombëtare Autorizuese (ZKA), Ministria e Financave, Mali i Zi
- Milos Marković, Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë për Bashkëpunimin Territorial Evropian, Ministria e Çështjeve Evropiane, Mali i Zi
- Bojan Vujović, Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë për Koordinimin e Ndihmës Financiare të BE-së, Zëvendës NIPAC, Ministria e Çështjeve Evropiane, Mali i Zi
- Andi Mehmeti, Zëvendës Ministër i Financave, Zyrtar Kombëtar Autorizues (ZKA), Ministria e Financave, Shqipëri
- Sonil Bilaj, Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, Shqipëri



Shtojca 1: Letër përgjigje

Bruksel, 21 tetor 2025

Znj. Valentina Superti
Drejtore B
Drejtoria e Përgjithshme e Zgjerimit dhe Fqinjësisë Lindore

Lënda: Përgjigje ndaj kërkesës suaj për Ndryshim Nr.2 të Marrëveshjes së Financimit për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi- Shqipëri për periudhën 2021-2027

I nderuar Drejtor,

Në vijim të letrës suaj me referencën e lartpërmendur, ju propozoni ndryshimet e mëposhtme në Marrëveshjen e Financimit për “Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi - Republika e Shqipërisë për periudhën 2021-2027” (në vijim e referuar si “**Marrëveshja e Financimit**”):

Neni 1(1) i Kushteve të Veçanta të Marrëveshjes së Financimit do të zëvendësohet me sa vijon:

“Neni 1

- (1) Bashkimi pranon të financojë dhe përfituesit e IPA III bien dakord të pranojnë financimin e Programit të mëposhtëm të Bashkëpunimit Ndërkufitar (CBC/BNK), siç përshkruhet në Aneksin I:

Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi – Shqipëri për periudhën 2021–2027
Numri(at) i angazhimit global:

Për vitin 2022: JAD.976622

Për vitin 2025: JAG.SUM.2094421

Ky Program i Bashkëpunimit Ndërkufitar (CBC) financohet nga buxheti i Bashkimit në bazë të aktit themelor vijues: “Instrumenti i Ndihmës për Para-Aderimin (IPA III)”

- (2) Kostoja totale e parashikuar e këtij Programi të Bashkëpunimit Ndërkufitar (CBC) është 13,790,000 Euro dhe kontributi maksimal i Bashkimit në këtë Program është caktuar në 11,900,000 Euro.



Ky kontribut i Bashkimit do të ndahet në angazhime vjetore për periudhën 2022, 2025 dhe 2027, në përputhje me Aneksin I. Asgjë në këtë Marrëveshje Financimi nuk mund të interpretohet si një angazhim financiar i Bashkimit në lidhje me kreditë që ende nuk janë miratuar me miratimin e buxhetit të BE-së. Komisioni do t'i informojë me shkrim përfituesit e IPA III mbi miratimin e angazhimeve financiare të mëtejshme të përcaktuara në Aneksin I.

Nuk kërkohet asnjë kontribut financiar nga përfituesit e IPA III”.

Duke iu referuar letrës suaj me referencë, lidhur me miratimin e angazhimit financiar për vitin 2025, me anë të kësaj shpreh miratimin tim për Ndryshimin Nr. 2 të Marrëveshjes së Financimit. Ky Ndryshim do të hyjë në fuqi në datën e fundit të nënshkrimit të letrave, pas përfundimit të procedurave ligjore të brendshme të përfituesve të IPA III, me pranimin e kësaj kërkesë nga dy përfitues të IPA III. Komisioni do t'i njoftojë përfituesit e IPA III për datën e hyrjes në fuqi, e cila nuk do të jetë më vonë se 31 dhjetor 2026.

Sinqerisht,

Koordinatorë Kombëtare e IPA-s

 Ref. Ares(2025)9032785 - 22/10/2025EUROPEAN COMMISSION
ENLARGEMENT AND EASTERN NEIGHBOURHOODB - WESTERN BALKANS
Director

Brussels, 21/10/2025

Subject: Amendment No. 2 to the Financing Agreement through Exchange of Letters on the Cross-border cooperation programme Montenegro - Albania for 2021-2027

Dear Minister Gorčević,

Dear Ms Čano,

The Commission, Montenegro and Albania authorities originally concluded a Financing Agreement on the Cross-border cooperation programme Montenegro – Albania for 2021-2027 on 14 November 2023 (hereinafter “the Financing Agreement”).

In accordance with Article 1(2) of the Special Conditions of the Financing Agreement, the purpose of this amendment is to approve the financial commitment to the amount of EUR 5,100,000 for year 2025 (EU contribution), as indicated in Annex I.

In accordance with Article 2(1) of the Special Conditions, the execution period of the Financing Agreement for 2025 budgetary allocation is set to 12 years from the date of entry into force of this amendment through exchange of letters.

In accordance with Article 2(2) of the Special Conditions, the operational implementation period for 2025 budgetary allocation is set to 6 years from the date of entry into force of this amendment through exchange of letters.

Regarding Article 1 (2) of the Special Conditions of the Financing Agreement, the purpose of this amendment is to simplify the approval of future budget allocations by amending Article 1 (2) to switch from an exchange of letters between the Commission and the IPA III beneficiaries to the Commission informing in writing the IPA III beneficiaries about the adoption of subsequent yearly budget commitments.

The following amendment to the Financing Agreement is deemed necessary:

1. Article 1(1) of the Special Conditions of the Financing Agreement shall be replaced by the following:

“Article 1

- (1) The Union agrees to finance and the IPA III beneficiaries agree to accept the financing of the following CBC Programme as described in Annex I:

Cross-border cooperation programme Montenegro - Albania for 2021-2027 Global commitment number(s): ACT-60806

Ms Maida Gorčević
National IPA Coordinator
Minister
Ministry of European Affairs
Bulevar Ivana Crnojevića 167
81 000 Podgorica, Montenegro
E-mail: maida.gorcevic@mep.gov.me

Ms Eridana Čano
National IPA Coordinator
General Director State Agency of Strategic
Programming and Aid Coordination
"Kuvajt" Street
Tirana, Albania
Email: Eridana.Cano@saspac.gov.al



For year 2022: JAD.976622

For year 2025: JAG.SUM.2094421

This CBC Programme is financed from the Union Budget under the following basic act: Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA III).

- (2) The total estimated cost of this CBC Programme is EUR 13 790 000 and the maximum Union contribution to this CBC Programme is set at 11 900 000.

This Union contribution shall be split into yearly commitments for the period 2022, 2025 and 2027 in accordance with Annex I. Nothing in this Financing Agreement can be interpreted as implying a financial commitment of the Union in relation to credits which have not yet been approved by adoption of the EU budget. The Commission shall inform in writing the IPA III beneficiaries about the adoption of the subsequent financial commitments indicated in Annex I.

No financial contribution is required from the IPA III beneficiaries.”

All the other provisions of the Financing Agreement remain unchanged.

May I please ask that you answer to this letter with your agreement on the changes explained above, using the model reply letter in Appendix 1.

This exchange of letters shall constitute Amendment No 2 to the Financing Agreement which shall enter into force upon the last signature date of the letters following the completion of internal legal procedures of the IPA III beneficiaries, accepting the amendment from two IPA III beneficiaries. The Commission shall notify the IPA III beneficiaries of the entry into force date, which shall be at the latest 31 December 2026.

I look forward to receiving your replies agreeing to this amendment.

Yours sincerely,

Valentina Superti

Encl. Reply letter accepting the amendment as Appendix 1

“cc”

Milica Adžić, State Secretary and National Authorising Officer (NAO), Ministry of Finance, Montenegro

Milos Marković, Director General of the Directorate for European Territorial Cooperation, Ministry of European Affairs, Montenegro

Bojan Vujović, Director General of the Directorate for Coordination of EU Financial Assistance, Deputy NIPAC, Ministry of European Affairs, Montenegro

Andi Memeti, Deputy Minister of Finance, National Authorising Officer (NAO), Ministry of Finance, Albania

Sonil Bilaj, State Agency for Strategic Programming and Aid Coordination, Albania



Appendix 1: Reply letter

21 OCT. 2025

Brussels, ... 2025

Ms Valentina Superti
Director B
Directorate General Enlargement and Eastern Neighbourhood

Subject: Response to your request for amendment No 2 to the Financing Agreement on the Cross-border cooperation programme Montenegro - Albania for 2021-2027

Dear Director,

Following your letter in reference above, you propose the following changes to the Financing Agreement on the CBC Montenegro - Albania 2021-2027 (hereinafter “**the Financing Agreement**”):

Article 1(1) of the Special Conditions of the Financing Agreement shall be replaced by the following:

“Article 1

- (1) The Union agrees to finance and the IPA III beneficiaries agree to accept the financing of the following CBC Programme as described in Annex I:

Cross-border cooperation programme Montenegro - Albania for 2021-2027

Global commitment number(s):

For year 2022: JAD.976622

For year 2025: JAG.SUM.2094421

This CBC Programme is financed from the Union Budget under the following basic act: “Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA III)

- (2) The total estimated cost of this CBC Programme is EUR 13 790 000 and the maximum Union contribution to this CBC Programme is set at 11 900 000.

This Union contribution shall be split into yearly commitments for the period 2022, 2025 and 2027 in accordance with Annex I. Nothing in this Financing Agreement can be interpreted as implying a financial commitment of the Union in relation to credits which have not yet been approved by adoption of the EU budget. The Commission shall inform in writing the IPA III beneficiaries about the adoption of the subsequent financial commitments indicated in Annex I.

~~No financial contribution is required from the IPA III beneficiaries.”~~

Further to your letter under reference, concerning the approval of the financial commitment for 2025, I hereby agree on the Amendment No 2 to the Financing Agreement. This amendment shall enter into force at the last signature date of the letters following the completion of internal legal procedures of the IPA III beneficiaries, accepting this request from two IPA III beneficiaries. The Commission shall notify the IPA III beneficiaries of the entry into force, which shall be at the latest 31 December 2026.

Yours sincerely,

National IPA Coordinator



Appendix I: Reply letter

21 OCT. 2025

Brussels, ... 2025

Ms Valentina Superti
Director B
Directorate General Enlargement and Eastern Neighbourhood

Subject: Response to your request for amendment No 2 to the Financing Agreement on the Cross-border cooperation programme Montenegro - Albania for 2021-2027

Dear Director,

Following your letter in reference above, you propose the following changes to the Financing Agreement on the CBC Montenegro - Albania 2021-2027 (hereinafter **"the Financing Agreement"**):

Article 1(1) of the Special Conditions of the Financing Agreement shall be replaced by the following:

"Article 1

- (1) The Union agrees to finance and the IPA III beneficiaries agree to accept the financing of the following CBC Programme as described in Annex I:

Cross-border cooperation programme Montenegro - Albania for 2021-2027

Global commitment number(s):

For year 2022: JAD.976622

For year 2025: JAG.SUM.2094421

This CBC Programme is financed from the Union Budget under the following basic act: "Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA III)

- (2) The total estimated cost of this CBC Programme is EUR 13 790 000 and the maximum Union contribution to this CBC Programme is set at 11 900 000.

This Union contribution shall be split into yearly commitments for the period 2022, 2025 and 2027 in accordance with Annex I. Nothing in this Financing Agreement can be interpreted as implying a financial commitment of the Union in relation to credits which have not yet been approved by adoption of the EU budget. The Commission shall inform in writing the IPA III beneficiaries about the adoption of the subsequent financial commitments indicated in Annex I.

No financial contribution is required from the IPA-III-beneficiaries:

Further to your letter under reference, concerning the approval of the financial commitment for 2025, I hereby agree on the Amendment No 2 to the Financing Agreement. This amendment shall enter into force at the last signature date of the letters following the completion of internal legal procedures of the IPA III beneficiaries, accepting this request from two IPA III beneficiaries. The Commission shall notify the IPA III beneficiaries of the entry into force, which shall be at the latest 31 December 2026.

Yours sincerely,

Tirana on 10/03/2026

National IPA Coordinator





DEKRET
Nr. 332, datë 1.6.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 48/2026, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 2, me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Malit të Zi dhe Komisionit Evropian për programin IPA të bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi–Shqipëri 2021–2027, ratifikuar me ligjin nr. 9/2024”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 49/2026

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 113/2020,
“PËR SHTETËSINË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Pika 3 e nenit 8 shfuqizohet.

Neni 2

Pas nenit 8 shtohet neni 8/a me këtë përmbajtje:

“Neni 8/a

Fitimi i shtetësisë nga martesë

1. I huaji ose e huaja që janë të martuar me shtetase ose shtetas shqiptar, martesë e të cilëve është regjistruar në regjistrin e martesave të gjendjes civile në Republikën e Shqipërisë, fitojnë shtetësinë shqiptare pas kalimit të katër vjetëve nga data e lidhjes së martesës në shtetin e tyre ose në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht nëse janë rezidentë në Republikën e Shqipërisë ose jo.

2. Shtetësia sipas këtij neni jepet edhe kur martesë është lidhur së paku tre vjet përpara datës së aplikimit, me kushtin që i huaji ose e huaja të jenë rezidentë në Republikën e Shqipërisë prej së paku një viti nga data e aplikimit.

3. Shtetësia sipas këtij neni jepet edhe kur martesë është lidhur së paku dy vjet përpara datës së aplikimit, me kushtin që nga lidhja e të huajit ose të huajës me shtetasen ose shtetasin shqiptar të ketë lindur së paku një fëmijë.

4. I huaji ose e huaja që aplikon për fitimin e shtetësisë sipas këtij neni duhet të plotësojë kushtet e përcaktuara nga shkronjat “dh” dhe “ë” të pikës 1 të nenit 8.”.

Neni 3

Në nenin 9 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Titulli i nenit bëhet “Natyralizimi për interes shtetëror”.

b) Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. I huaji fiton shtetësinë shqiptare jashtë kushteve të përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji për moshën, njohuritë gjuhësore e historike, si dhe afatin e qëndrimit të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë në rast se shteti shqiptar ka interes të posaçëm shtetëror për krijimin e një lidhjeje të qëndrueshme me personin e huaj për shkak të cilësive, aftësive dhe rrethanave specifike të dobishme të individit ose të veprimtarisë së tij, private ose publike”.

c) Pika 1/1 zhvendoset pas pikës 3 dhe numërohet pika 3/1.

ç) Në vendin e pikës 1/1 vendoset pika e re 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1 Interesi i posaçëm shtetëror identifikohet, mbështetet dhe garantohet përpara Presidentit të Republikës nga ministri që mbulon fushën



përkatëse. Nuk pranohen aplikime sipas këtij neni pa dokumentacionin mbështetës-garantues nga këto autoritete.”.

d) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Procedurat e aplikimit dhe e ndërveprimit institucional, kushtet, kriteret, rrethanat, dokumentimi dhe vërtetimi i interesit shtetëror, si dhe rregullat specifike të kontrollit të sigurisë dhe pastërtisë së figurës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Vendimi i Këshillit të Ministrave përcakton gjithashtu ngritjen e një agjencie shtetërore të posaçme në varësi të ministrit përgjegjës për punët e brendshme, e cila ka kompetencë shqyrtimin, verifikimin dhe vlerësimin e aplikimeve, si dhe të rrethanave që formojnë interes shtetëror për dhënien e shtetësisë sipas këtij neni”.

dh) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Kërkesat e vlerësuara si të ligjshme i përcillen, me propozimin për dhënien e shtetësisë, Presidentit të Republikës nga ministri përgjegjës për punët e brendshme.”.

e) Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Natyralizimi i anëtarëve të familjes së personit të natyralizuar sipas këtij neni, në rast se kërkohet, u nënshtrohet kushteve dhe kërkesave të nenit 8 të këtij ligji”.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 8.5.2026.

Shpallur me dekretin nr. 333, datë 1.6.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 333, datë 1.6.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 49/2026, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 113/2020, ‘Për shtetësinë’, i ndryshuar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ

Nr. 50/2026

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 99/2024, “PËR INSPEKTIMIN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në pikën 1 të nenit 12 fjalët “në varësi të Kryeministrit” zëvendësohet me fjalët “në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë”.

Neni 2

Në shkronjën “d” të nenit 18 fjalët “Këshillit të Ministrave” zëvendësohen me fjalët “ministrit përgjegjës për ekonominë”.



Neni 3

Në nenin 40 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 fjalët “jo më vonë” zëvendësohen me fjalët “jo më pak”.

2. Në pikën 2 bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) në shkronjën “c” fjalët “në pikën 5” zëvendësohen me fjalët “në pikën 6”;

b) në shkronjën “ç” fjalët “në pikën 1” zëvendësohen me fjalët “në pikat 1 dhe 2”.

Neni 4

Në pikën 7 të nenit 42 fjalët “jo më vonë” zëvendësohen me fjalët “jo më pak”.

Neni 5

Në pikën 2 të nenit 43 fjalët “në pikën 6” zëvendësohen me fjalët “në pikën 9”.

Neni 6

Në pikën 2 të nenit 105 fjalët “jo më vonë” zëvendësohen me fjalët “jo më pak”.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 8.5.2026.

Shpallur me dekretin nr. 334, datë 1.6.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET**Nr. 334, datë 1.6.2026****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 50/2026, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 99/2024, ‘Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë’”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM**Nr. 67/2026****PËR MOSMIRATIMIN E KËRKESËS
PËR ZHVILLIMIN E NJË
INTERPELANCE URGJENTE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe neneve 55, 89, pika 3, të Rregullores së Kuvendit, me kërkesë të një grupi deputetësh të Partisë Demokratike,

KUVENDI**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Mosmiratimin e kërkesës për zhvillimin e interpelancës urgjente me Kryeministrin e Shqipërisë për çështjen e AKSHI-t.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miraturar në datën 7.5.2026.

VENDIM**Nr. 81/2026****PËR MOSMIRATIMIN E KËRKESËS
PËR ZHVILLIMIN E NJË
INTERPELANCE URGJENTE**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe neneve 55, 89, pika 3, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike,

KUVENDI**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Mosmiratimin e kërkesës për zhvillimin e interpelancës urgjente me Kryeministrin e Shqipërisë për pretendimet dhe çështjet e ngritura publikisht për procedurat e prokurimit publik të projektit “Smart City”.



II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miraturar në datën 14.5.2026.

VENDIM
Nr. 83/2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 166,
DATË 16.12.2004, “PËR MIRATIMIN E
RREGULLORES SË KUVENDIT
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”,
I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 75, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 117 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 166, datë 16.12.2004, “Për miratimin e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 7 në fund të pikës 3/1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Kryesimi i grupeve të miqësisë përcaktohet nga Kryetari i Kuvendit në këshillim me kryetarët e grupeve parlamentare duke mbajtur parasysh përfaqësimin politik sipas përpjesëtimit që zënë në Kuvend.”.

Neni 2

Në nenin 10, pika 3, fjalia e tretë ndryshohet si më poshtë:

“Sekretariati për Procedurat, Votimet dhe Etikën përbëhet nga një sekretar dhe pesë anëtarë, në raporte të barabarta ndërmjet shumicës dhe pakicës parlamentare dhe kur votat në këtë Sekretariat

ndahen në mënyrë të barabartë, vota e Sekretarit është përcaktuese.”.

Neni 3

Neni 17 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 17
Kushtet e punës për grupet parlamentare

1. Grupeve parlamentare u sigurohen mjediset e punës dhe pajisjet e nevojshme për funksionimin e tyre, në dispozicion të deputetëve dhe të stafit mbështetës.

2. Çdo grupi parlamentar i vihet në dispozicion staf politik mbështetës. Grupi parlamentar më i madh i shumicës dhe grupi parlamentar më i madh i pakicës kanë në dispozicion një numër stafi politik mbështetës të barabartë, i cili nuk mund të jetë më i vogël se numri i përgjithshëm i komisioneve të përhershme, dhe që përcaktohet me vendim të Byrosë së Kuvendit. Grupet e tjera parlamentare kanë në dispozicion një numër stafi politik mbështetës në proporcion me madhësinë e grupit parlamentar, sipas numrit dhe pozicionit të përcaktuar me vendim të Byrosë së Kuvendit.”.

Neni 4

Në nenin 19 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kuvendi miraton në seancë plenare ngritjen e 11 komisioneve të përhershme me emërtesat dhe fushat e përgjegjësisë, si më poshtë:

Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe Financat.

(Çështjet e politikave ekonomike me përfaqësimin ndaj tregut të përbashkët evropian, Buxhetin e Shtetit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tij, marrëdhëniet e punësimit, lirisë së lëvizjes së punëtorëve, financat publike, privatizimet dhe sistemi bankar.)

Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike.

(Kodet dhe ligjet duke garantuar përputhshmërinë dhe zbatueshmërinë e tyre me standardin evropian, organizimin e pushtetit gjyqësor dhe raportimin e tij, administratën e pushtetit gjyqësor, administratën publike, institucionet e pavarura në sistemin e drejtësisë.)

Komisioni për Çështjet e Brendshme dhe të Mbrojtjes.



(Çështjet e brendshme, të rendit, organizimin e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare e publike, organizimin e forcave të armatosura dhe bashkëpunimin ushtarak, çështjet e organizimit dhe funksionimit të pushtetit vendor, emergjencat civile dhe mbrojtja nga fatkeqësitë, shërbimet sekrete.)

Komisioni për Edukimin, Shkencën dhe Sportet.

(Çështjet në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, inovacionit dhe politikave të zhvillimit të sportit.)

Komisioni për Shëndetësinë dhe Mirëqenien Sociale.

(Çështjet lidhur me politikave shëndetësore, sigurimet shoqërore, familjen, gruan dhe çështjet për mirëqenien sociale.)

Komisioni për Burimet Natyrore, Infrastrukturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm.

(Çështjet në fushën e energjisë, burimeve natyrore dhe biodiversitetit, infrastrukturën, industrinë dhe telekomunikacionin, rregullimin e territorit, tregtinë dhe mbrojtjen e mjedisit dhe çështjet për zhvillimin e qëndrueshëm.)

Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik.

(Çështjet në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, çështjet lidhur me veprimtarinë e mediave audiovizive dhe informimit dhe çështjet për garantimin e lirisë së shprehjes.)

Komisioni për Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural.

(Çështjet e bujqësisë, blegtorisë dhe peshkimit, çështjet e zhvillimit rural, çështjet e kontrollit dhe garantimit të sigurisë ushqimore, monitorimin e zbatimit të politikave në fushën e bujqësisë dhe të sigurisë ushqimore.)

Komisioni për Kulturën, Turizmin dhe Diasporën.

(Çështjet e kulturës kombëtare dhe trashëgimisë kulturore, zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm, politikave për ruajtjen e identitetit kulturor, gjuhësor të diasporës dhe të pjesëmarrjes së saj në proceset politike dhe sociale në vend.)

Komisioni për Evropën dhe Punët e Jashtme.

(Çështjet e integritetit evropian, përafrimi i legjislacionit me legjislacionin e Bashkimit Evropian, mbikëqyrja e zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, mbikëqyrja e asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Shqipërinë, monitorimi i negociatave të anëtarësimit me Bashkimin Evropian, politikave të jashtme, marrëdhëniet dhe bashkëpunimi ndërkombëtar, si dhe zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare.)

Komisioni për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale.

(Monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të strategjive, rezolutave, vendimeve dhe planeve të veprimtari të Kuvendit; shqyrtimi dhe ndjekja e nismave të qytetarëve dhe peticioneve; realizimi dhe koordinimi, mbikëqyrja dhe kontrolli i zbatimit

të ligjeve nga ekzekutivi, institucionet dhe agjencitë e pavarura prej tij, përmes koordinimit të procesit parlamentar për kontrollin post-legjislativ (PLS); koordinimi i dialogut dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.)

2. Kudo në Rregulloren e Kuvendit emërtesat e komisioneve të përhershme zëvendësohen sipas emërtesave të komisioneve të përhershme në nenin 19, pika 1, të këtij vendimi.

Neni 5

Në nenin 20 pika 3 shfuqizohet.

Neni 6

Në nenin 27/1, pika 3, fjalët “si rregull 7 ditë përpara” hiqen.

Neni 7

Në nenin 28 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2 fjalja e dytë hiqet.

2. Në fund të pikës 5 shtohen fjalët “me përjashtim të projektligjeve që synojnë përafrimin e legjislacionit, marrëveshjet që lidhen me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe/ose detyrimeve që dalin nga procesi i negociatave të anëtarësimit, kur shqyrtimi i tyre është i nevojshëm për respektimin e afateve që rrjedhin nga procesi i negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian.”

Neni 8

Në nenin 32 në fund të pikës 2 shtohet fjalja më këtë përmbajtje:

“Kur mbledhja e komisionit thirret nga një e katërta e anëtarëve të tij, komisioni mbledhet brenda 2 ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesës.”

Neni 9

Në nenin 34, pika 2, pas fjalëve “kalendarin dhe punimet e tij” shtohen fjalët “për bashkimin e nismave, të cilat i referohen të njëjtit ligj ose të njëjtit objekt.”

Neni 10

Në nenin 36 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit bëhet “Seanca dëgjimore publike në procesin legjislativ”.



2. Në fund të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Kur seanca dëgjimore kërkohet nga një e treta e anëtarëve të komisionit, komisioni mblidhet brenda 2 ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesës.”.

Neni 11

Në nenin 38, pika 3, pas fjalëve “Diskutimi në parim bëhet gjithmonë në prani të” shtohen fjalët “nismëtarit, si dhe”.

Neni 12

Në nenin 39 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshon si më poshtë:

“1. Mbledhjet e komisioneve regjistrohen dhe transkriptohen në mënyrë të plotë në procesverbalin e mbledhjes.”.

2. Në pikën 2 fjalët “procesverbal i përmbledhur” zëvendësohen me fjalën “procesverbal”.

3. Pika 3 hiqet.

4. Kudo në tekstin e Rregullores fjalët “procesverbal i përmbledhur” zëvendësohen me fjalën “procesverbal”.

Neni 13

Në nenin 48, pika 1, pas fjalisë së tretë shtohet fjalia e katërt me këtë përmbajtje:

“Ky rregull zbatohet për të gjitha aktet që shqyrtohen dhe miratohen nga Kuvendi.”.

Neni 14

Në nenin 49 pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1 Në rast të zgjatjes së seancës plenare përtej orës 22:00, çdo kryetar grupi parlamentar mund të kërkojë ndërprerjen e seancës dhe rifillimin e saj në ditën pasardhëse. Ndërprerja e seancës bëhet me votim të hapur nga Kuvendi.”.

Neni 15

Në nenin 52 fjalët “dhe vetëm një herë për të njëjtën çështje” hiqen.

Neni 16

Në nenin 58, pika 2, pas fjalëve “dhe të përbërjes së Këshillit të Ministrave” shtohen fjalët “shqyrtimit të projektligjeve”.

Neni 17

Në nenin 63, pika 1, shkronja “d”; në nenin 65, pika 2; në nenin 65/1 dhe në nenin 65/2 fjalët “10 ditë, 30 ditë ose 60 ditë” zëvendësohen me fjalët “10, 30 ose 60 ditë kalendarike”.

Neni 18

Në nenin 65/2 pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Masat disiplinore “përfashtim nga pjesëmarrja në seanca plenare/komisione” llogaritet me ditë kalendarike dhe shoqërohet me sanksion financiar të ndalimit të pagës së deputetit për aq ditë sa është marrë masa disiplinore.”.

Neni 19

Në nenin 65/3 pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Me paraqitjen e ankimit, vendimi i Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën pezullohet deri në dhënien e vendimit nga Byroja e Kuvendit.”.

Neni 20

Në nenin 68 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 2 pas fjalës “relacion” shtohen fjalët “i cili nisur nga qëllimi, objektivat e hartimit të tij dhe *acquis communautaire*”.

2. Pas pikës 2/1 shtohet pika 2/2 me këtë përmbajtje:

“2/2. Projektligjet që synojnë përfrimin e legjislacionit, marrëveshjet që lidhen me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe/ose detyrimeve që dalin nga procesi i negociatave të anëtarësimit depozitohen në Kuvend të shoqëruara me kartelën përkatëse “BE”, e cila hartohet nga propozuesi dhe përmban në mënyrë të përmbledhur:

a) referencat ndaj instrumenteve përkatëse të *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian;



b) natyrën dhe shkallën e përafrimit (transpozim, amendim ose zbatim);

c) lidhjen e projektligjit me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe/ose procesi i negociatave për anëtarësim;

ç) çdo element tjetër të nevojshëm për identifikimin e ndikimit të projektligjit në legjislacionin e përafuar me *acquis* të Bashkimit Evropian.”.

Neni 21

Në nenin 83 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit 83 bëhet: “Shqyrtimi nen për nen i buxhetit në komisione.”

2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Me miratimin në parim të projektligjit për buxhetin e shtetit dhe projektligjeve financiare në seancë plenare, komisionet e përhershme të Kuvendit fillojnë shqyrtimin nen për nen të projektligjit për buxhetin. Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, fillon shqyrtimin nen për nen duke shqyrtuar edhe rekomandimet apo amendamentet në raportet e komisioneve për dhënie mendimi, si dhe të Sekretariatit për Buxhetin e Kuvendit ose nga Kuvendi në seancë plenare.”.

Neni 22

Në nenin 86 në pikën 8 pas fjalëve “Në rastin e pranimi të dekretit” shtohen fjalët “edhe nëse Kuvendi vlerëson se jo çdo argument i dekretit është i vlefshëm për kthimin e ligjit”.

Neni 23

Në nenin 87 bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 1 pas shkronjës “d” shtohet shkronja “dh” me këtë përmbajtje:

“dh) vendime të tjera të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 132 të Kushtetutës, zbatimi i të cilave është përcaktuar si detyrim i Kuvendit të Shqipërisë.”.

2. Pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Në rastet kur Këshilli i dërgon/paraqet nismëtarit rekomandimet për ndërmarrjen e nismës, ky i fundit detyrohet të raportojë për zbatimin e tyre në komisionin përgjegjës që ka miratuar aktin brenda afateve të përcaktuara nga Gjykata

Kushtetuese në vendim ose brenda 6 muajve nga dërgimi i këtij rekomandimi.”.

Neni 24

Në fund të nenit 88 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Në rastin e akteve normative me fuqinë e ligjit të nxjerra nga Këshilli i Ministrave, procedura e votimit është vetëm një votim për miratimin ose mosmiratimin e tyre.”.

Neni 25

Në nenin 96, pika 3, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Ato përfshihen në rend dite në një nga tri seancat pasardhëse nga data e paraqitjes, përveçse kur është kërkuar sipas rregullave të nenit 97 të kësaj Rregulloreje.”.

Neni 26

Pas nenit 99 shtohet neni 99/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 99/1

E drejta për informim

1. Deputeti ka të drejtë të kërkojë informacione dhe shpjegime për çdo çështje që ka të bëjë me përmbushjen e detyrës së tij nga çdo institucion i pushtetit qendror dhe vendor.

2. Titullarët e institucioneve janë të detyruar t'i përgjigjen deputetit brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.

3. Në rast shkelje të pikës 2 të këtij neni, me kërkesë të kryetarit të një grupi parlamentar, Kryetari i Kuvendit i kërkon titullarit të institucionit të kthejë përgjigje brenda 5 ditëve. Nëse nuk respektohet ky afat, Kryetari i Kuvendit i drejtohet organit epror duke kërkuar marrjen e masave për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar dhe nxjerrjen e përgjegjësive administrative për refuzimin e përmbushjes së detyrimit sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni.”.

Neni 27

Në nenin 103 bëhen këto ndryshime:



1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Raporti i institucioneve, pas paraqitjes, futet menjëherë në programin e punës së Kuvendit. Komisioni përgjegjës sipas fushës përkatëse të përgjegjësisë së institucioneve organizon seancë dëgjimore në prani të drejtuesit të organit kushtetues ose organit të krijuar me ligj për raportimin dhe shqyrtimin e raportit vjetor të institucionit dhe në përfundim të diskutimeve harton një projektrezolutë për vlerësimin e punës së institucionit me rekomandimet përkatëse për vitin pasardhës dhe ia përcjell atë Komisionit për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale brenda afatit 3-ditor.”

2. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 si më poshtë:

“3/1. Komisioni për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale merr në shqyrtim projektrezolutën e hartuar nga komisioni përgjegjës në prani të drejtuesit të organit kushtetues ose organit të krijuar me ligj që raporton dhe të relatorit/relatorëve të komisionit përgjegjës, në rast se çmohet e nevojshme prej tyre. Gjatë këtij procesi ky komision vlerëson si fillim zbatimin e rezolutës së Kuvendit për vitin paraardhës. Në përfundim të shqyrtimit Komisioni për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale miraton projektrezolutën që i kalon seancës plenare. Në seancë plenare projektrezoluta prezantohet nga relatori/relatorët e Komisionit për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale dhe relatori/relatorët e komisionit përgjegjës në rast se ka rekomandime të komisionit përgjegjës që nuk janë reflektuar në projektrezolutën e paraqitur në seancë.”

3. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Në seancë plenare, institucionet kushtetuese, Avokati i Popullit, Prokurori i Përgjithshëm, Drejtuesi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Drejtuesi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit paraqesin një përmbledhje të raportit jo më shumë se 10 minuta dhe më pas iu përgjigjen pyetjeve të deputetëve. Pyetjet depozitohen me shkrim nga çdo deputet jo më vonë se 24 orë para seancës. Në vijim lexohet projektrezoluta e komisionit përkatës për vlerësimin e punës së institucionit.

4. Në pikën 8 fjalë e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Koha e debatit është jo më shumë se 120 minuta.”

Neni 28

Në nenin 103/1 bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Pika 6 ndryshon si më poshtë:

“6 Komisionet e përhershme parlamentare sipas fushës përkatëse të përgjegjësisë mund të thërrasin institucionet kushtetuese të pavarura dhe institucionet e krijuara me ligj që të raportojnë dhe informojnë Kuvendin për çështje të integritetit evropian, duke u koordinuar paraprakisht me Komisionin për Evropën dhe Punët e Jashtme.”

2. Në fund të pikës 7 shtohet fjalë me këtë përmbajtje:

“Para miratimit kalendari koordinohet me Komisionin përgjegjës për Evropën dhe Punët e Jashtme.”

Neni 29

Në nenin 103/3 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Pas miratimit të planit nga Konferenca e Kryetarëve, Kryetari i Kuvendit ia përcjell planin vjetor me afatet kohore të përcaktuara ministrit përgjegjës për Marrëdhëniet me Parlamentin, ministrit përgjegjës për negociatat me Bashkimin Evropian dhe/ose Kryenegociatorit dhe ministrive përgjegjëse.”

3. Në pikën 4 fjalët “Komisioni për Çështjet Evropiane” zëvendësohen me fjalën “komisioneve”.

Neni 30

Në nenin 103/4 pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Komisioni përgjegjës për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale koordinon dhe mbikëqyr zbatimin e strategjive dhe planeve të veprimit të miratuara nga Kuvendi. Në mbyllje të çdo sesioni ai i paraqet Konferencës së Kryetarëve një raport informues për këtë proces. Kryetari i Kuvendit, nëse e çmon të arsyeshme, vendos paraqitjen e tij në seancë plenare.”

Neni 31

Neni 104 ndryshon, si më poshtë:



“Neni 104

Nismat qytetare dhe peticionet

1. Nismat qytetare dhe peticionet, të cilat i drejtohen Kuvendit, shqyrtohen nga Komisioni përgjegjës për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale.

2. Pranohen për shqyrtim nismat dhe peticionet të cilat janë bërë me shkrim, kanë emrin e dërguesit dhe nënshkrimet përkatëse, janë të kuptueshme dhe tregojnë qartë objektin e tyre.

3. Kërkesa me nismat qytetare dhe peticionet dërgohen nga Kryetari i Kuvendit në Komisionin përgjegjës për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale. Kryetari i komisionit mund t’ua kthejë nismën ose peticionin dërguesve për rihartim ose t’u kërkojë atyre sqarime shtesë.

4. Jo më vonë se 45 ditë nga data e marrjes së peticionit, kryetari i komisionit e paraqet kërkesën me nismën ose peticionin në komision duke propozuar njëkohësisht edhe mënyrën e trajtimit dhe zgjidhjes ligjore ose mospranimin e tij. Në rast se komisioni e gjykon të arsyeshme zgjidhjen e çështjes, mund të autorizojë kryetarin e komisionit për të paraqitur një deklaratë në seancën plenare të Kuvendit. Hapat e ndërmarrë dhe zgjidhja e çështjes së ngritur në peticion u njoftohen dërguesve të peticionit.

5. Komisioni përgjegjës mund të vendosë dërgimin e nismës ose peticionit një komisioni tjetër parlamentar, që ka lidhje me objektin e peticionit, Këshillit të Ministrave, institucioneve publike dhe institucioneve të pavarura përgjegjëse për fushën për veprime të mëtejshme, me qëllim marrjen e informacioneve. Në përfundim, komisioni jep shpjegime me shkrim, propozon nismë legislative ose merr vendim.

6. Kuvendi miraton mekanizmin e trajtimit dhe shqyrtimit të nismave qytetare dhe peticioneve.”

Neni 32

Në nenin 110, pika 4, fjalë e dytë, fjalët “në përputhje me nenin 48 të kësaj Rregulloreje” zëvendësohen me fjalët “në mënyrë përpjesëtimore ndërmjet grupeve sipas përfaqësimit të tyre në Kuvend, por në çdo rast jo më shumë se 10 minuta për çdo deputet, me përjashtim të rastit të parashikuar nga neni 47, pika 1/2, të kësaj Rregulloreje.”

Neni 33

Neni 111 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 111

Zgjedhja në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj me propozim të institucioneve të tjera

1. Për kandidaturat në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj, të cilat zgjidhen nga Kuvendi, me propozim të institucioneve të tjera, me përjashtim të rasteve kur nuk është parashikuar ndryshe në Kushtetutë ose në ligj, zhvillohet procedura e përzgjedhjes, si më poshtë:

a) Sekretari i Përgjithshëm tre muaj përpara përfundimit të mandatit ose menjëherë në rastet e shkarkimit të anëtarit të organit kushtetues ose të krijuar me ligj njofton me shkrim institucionin propozues, i cili fillon praktikën për zgjedhjen e anëtarit të ri.

b) kandidaturat duhet të paraqiten në Kuvend 45 ditë përpara mbarimit të mandatit të anëtarit të organit dhe jo më vonë se 10 ditë pas shkarkimit të tij.

c) me paraqitjen e kandidaturave, Kryetari i Kuvendit ia kalon ato menjëherë komisionit përgjegjës, i cili brenda tre javëve nga marrja e kërkesës organizon seanca dëgjimore publike me secilin kandidat dhe vendos nëse kandidaturat i plotësojnë kriteret kushtetuese, ligjore dhe meritën.

ç) Në rastin kur ka mangësi në dokumentacion për kandidaturën, komisioni i kërkon zyrtarisht institucionit propozues plotësimin e tij. Në rastin kur kandidatura nuk plotëson kriteret ligjore të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, komisioni i kërkon Kryetarit të Kuvendit të njoftojë institucionin propozues. Procedura e shqyrtimit në Kuvend vazhdon me paraqitjen e kandidaturës së re nga institucioni propozues.

2. Kuvendi shqyrton propozimin dhe kryen votimin për kandidatët në seancë plenare brenda një jave nga paraqitja e raportit të komisionit përkatës.

3. Kur asnjë nga kandidatët nuk merr shumicën e kërkuar të votave, Kuvendi njofton institucionin propozues. Procedura fillon me kandidatura të tjera nga e para sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe.



Neni 34

Pas nenit 111 shtohet neni 111/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 111/1

Zgjedhja në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj me propozim të një grupi deputetësh

1. Për kandidaturat në organet kushtetuese ose të krijuara me ligj, të cilat zgjidhen nga Kuvendi, me propozim të një grupi deputetësh, me përjashtim të rasteve kur nuk është parashikuar ndryshe në Kushtetutë ose në ligj, zhvillohet procedura e përzgjedhjes, si më poshtë:

a) Komisioni përgjegjës tre muaj përpara mbarimit të mandatit të anëtarit të organit kushtetues ose të krijuar me ligj vendos shpalljen dhe publikimin e vakancës në faqen zyrtare të Kuvendit. Afati për paraqitjen e kandidaturave është 20 ditë nga publikimi i vendimit.

b) Në përfundim të afatit të përcaktuar në shpallje, komisioni përgjegjës u bën të njohur anëtarëve të Kuvendit listën me kandidaturat e vetofruara, si dhe brenda 5 ditëve nga dërgimi i listës organizon dëgjuesën e hapur publike në mjediset e Kuvendit, ku njoftohen të marrin pjesë të gjithë anëtarët e tij. Lista me kandidatët e vetofruar bëhet publike në faqen zyrtare të Kuvendit.

c) Brenda tre javëve nga dëgjesa publike, të paktën 28 deputetë përzgjedhin kandidatin që do të mbështesin për t’ia propozuar Kuvendit sipas cilësive profesionale dhe performancës gjatë prezantimit. Një deputet mund të mbështesë vetëm një kandidat.

ç) Mbështetja me nënshkrimet e të paktën 28 deputetëve depozitohet zyrtarisht në protokollin e Kuvendit. Kryetari i Kuvendit ia kalon propozimin menjëherë komisionit përgjegjës, i cili brenda tre javëve nga marrja e propozimit vendos nëse kandidaturat i plotësojnë kriteret kushtetuese, ligjore dhe meritën.

2. Kuvendi shqyrton propozimin dhe kryen votimin për kandidatët në seancë plenare brenda një jave nga paraqitja e raportit të komisionit përkatës.

3. Kur asnjë nga kandidatët nuk merr shumicën e kërkuar të votave, Kuvendi rishpall vakancën sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe.

Neni 35

Në nenin 115 pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kërkesa për shkarkimin e anëtarëve i paraqitet Kryetarit të Kuvendit me shkrim dhe në mënyrë të motivuar e konkrete për shkaqet e parashikuara në ligj nga jo më pak se 28 deputetë, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe.”.

Neni 36

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miraturar në datën 21.5.2026.

**VENDIM
Nr. 84/2026**

**PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT
PËR ADMINISTRATËN PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 19, pika 2, 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Ngritjen e Nënkomisionit për Administratën Publike në përbërje të Komisionit për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike, si dhe në përmbushjen e detyrimeve që lidhen me procesin e integritetit evropian të vendit.

II. Fusha e përgjegjësisë së këtij Nënkomisioni përfshin ndjekjen, analizimin dhe trajtimin e çështjeve që lidhen me organizimin, funksionimin, modernizimin, transparencën, llogaridhënien dhe rritjen e profesionalizmit të administratës publike.

III. Nënkomisioni përbëhet nga 7 anëtarë, si më poshtë:

1. Ermal Pacaj	kryetar (PS)
2. Aulona Bylykbashi	anëtare (PS)
3. Olsi Komici	anëtar (PS)



- | | |
|--------------------|---|
| 4. Gent Strazimiri | anëtar (PD) |
| 5. Saimir Korreshi | anëtar (PD) |
| 6. Tedi Blushi | anëtar (PL) |
| 7. Tedi Mula | anëtar (jashtë grupeve
parlamentare) |

Anëtarë zëvendësues:

- | | |
|----------------|------|
| 1. Erjo Mile | (PS) |
| 2. Arian Ndoja | (PD) |

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miraturar në datën 21.5.2026.

DEKRET
Nr. 336, datë 1.6.2026

PËR LIRIM AMBASADORI
NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “dh”, nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 37, pika 2, të ligjit nr. 24/2026, “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Donika Hoxha, Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Kroacisë, rezident, si dhe Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë i Republikës së Shqipërisë në Bosnjë dhe Hercegovinë, jo rezident, lirohet nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë të Republikës së Shqipërisë në Bosnjë dhe Hercegovinë, jo rezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 337, datë 1.6.2026

PËR LIRIM AMBASADORI
NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “dh”, nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 37, pika 2, të ligjit nr. 24/2026, “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Dastid Koreshi lirohet nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë të Republikës së Shqipërisë në Misionin e Përherëshëm të Republikës së Shqipërisë pranë Këshillit të Evropës në Strasburg, rezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 338, datë 1.6.2026

PËR LIRIM AMBASADORI
NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “dh”, nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 37, pika 2, të ligjit nr. 24/2026, “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Eglantina Gjermani lirohet nga detyra e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë të Republikës së Shqipërisë pranë Misionit të OSBE-së dhe Organizatave Ndërkombëtare në Vjenë, rezident.



Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 339, datë 1.6.2026****PËR EMËRIM AMBASADORI
NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “dh”, nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 37, pika 2, të ligjit nr. 24/2026, “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Spiro Koçi emërohet Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Bosnjë dhe Hercegovinë, rezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 340, datë 1.6.2026****PËR EMËRIM AMBASADORI
NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “dh”, nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 37, pika 2, të ligjit nr. 24/2026, “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Florian Nova emërohet Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së

Shqipërisë në Republikën Arabe të Egjiptit, rezident, si dhe Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën Arabe të Sirisë, në Mbretërinë Hashemite të Jordanisë, Shtetin e Libisë, Shtetin e Palestinës, Republikën Libaneze dhe në Republikën e Sudanit, jo rezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 341, datë 1.6.2026****PËR EMËRIM AMBASADORI
NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “dh”, nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 37, pika 2, të ligjit nr. 24/2026, “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Elvira Isufi emërohet Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Suedisë, rezident, si dhe Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Finlandës, Republikën e Islandës dhe në Mbretërinë e Norvegjisë, jo rezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj



DEKRET
Nr. 342, datë 1.6.2026

PËR EMËRIM AMBASADORI
NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “dh”, nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 37, pika 2, të ligjit nr. 24/2026, “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Dastid Koreshi emërohet Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë i Republikës së Shqipërisë në Misionin e Përherëshëm të Republikës së Shqipërisë pranë Zyrës së Kombeve të Bashkuara dhe Organizatave të Tjera Ndërkombëtare në Gjenevë, rezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 343, datë 1.6.2026

PËR EMËRIM AMBASADORI
NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “dh”, nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 37, pika 2, të ligjit nr. 24/2026, “Për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Ermal Muça, Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë i Republikës së Shqipërisë në Japoni, rezident, si dhe Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Filipineve, Republikën e Indonezisë, Republikën e Singaporit dhe në Malajzi,

jo rezident, emërohet edhe Ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Koresë, jo rezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

URDHËR
Nr. 300, datë 2.6.2026

PËR DELEGIMIN/AUTORIZIMIN E
KOMPETENCAVE TË MINISTRI TË
DREJTËSISË PËR NËNSHKRIMIN E
DOKUMENTACIONIT TË
KLASIFIKUAR “SEKRET SHTETËROR”
TE ZËVENDËSMINISTRI

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të nenit 28 e vijues të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të ministrit të Drejtësisë për nënshkrimin e korrespondencës dalëse me institucione të ndryshme, kur ato përfshijnë informacion të klasifikuar në nivelin “Sekret” dhe “Konfidencial”, të zëvendësministrit, znj. Elona Hoxha.

2. Ngarkimin e znj. Elona Hoxha me ndjekjen dhe me zbatimin e këtij urdhri, në përputhje me legjislacionin në fuqi lidhur me informacionin e klasifikuar.

3. Ngarkimin e Sektorit të Arkiv-Protokollit për marrjen e masave për ndjekjen dhe njoftimin e urdhrit strukturave përkatëse, që përpunojnë informacionin e klasifikuar në nivelet e sipërcituara.

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Toni Gogu
Faqe | 10709



VENDIM
Nr. 29, datë 30.5.2026

**PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË
TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË
NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE
TË GAZIT**

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 186, datë 19.3.2026, “Për shpalljen e situatës së veçantë në tregun e hidrokarbureve”; në zbatim të nenit 21/3 dhe nenit 21/5 të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar; si dhe të aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, “Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve të naftës, për benzinë të standardit SSHEN 2282018 dhe gazoil të standardit SSHEN 5902018.

2. Vlera “Premio” zbatohet sipas publikimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të një dite më parë.

3. Çmimet e miratuara nga Bordi, të cilat reflektojnë çmimet e nënprodukteve në bursë, të publikuara nga agjencia ndërkombëtare “S&P Global Platts” në USD, në kushtet e livrimit FOB Med, detyrimet doganore/tatimore që aplikohen, si dhe marzhe bruto maksimale të tregtimit (përfshijnë edhe TVSH-në), janë çmime tavan/maksimale në zbatim të metodologjisë së përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

4. Çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve, pas zbatimit të metodologjisë të përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, të ndryshuar, janë si më poshtë:

a) Çmimet tavan (max), për shitjen me shumicë të produkteve:

- 173 lekë/litri për gazoilin;
- 161 lekë/litri për benzinën.

b) Çmimet tavan (max), për shitjen me pakicë të produkteve:

- 185 lekë/litri për gazoilin;
- 173 lekë/litri për benzinën.

c) Çmimet tavan (max), për shitjen e gazoilit për peshkim:

- 90 lekë/litri për gazoilin për peshkim.

5. Referuar aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, “Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar, ku është parashikuar, se në rast se çmimi i shitjes me pakicë, për gazoil është më i lartë se 220 lekë/litri, apo për benzinën është më i lartë se 200 lekë/litri, zbatohet niveli 80% i akcizës. Bazuar në zbatimin e metodologjisë sipas pikës 4 të këtij vendimi, çmimet janë nën kufirin e aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, dhe për rrjedhojë niveli i akcizës do të zbatohet i plotë, 100%.

6. Ngarkohet administrata doganore të bëjë zbatimin në sistem të nivelit të plotë të akcizës për produktin gazoil sipas kodit të NKM-së: 27101944 me 39.376230 lekë/litri, dhe për produktin benzinë sipas kodeve të NKM-së: 27101245 dhe 27101249 me 39.376230 lekë/litri.

7. Asnjë operator ekonomik nuk mund t'i tregtojë këto nënprodukte mbi çmimet tavan të vendimit të Bordit. Çdo operator ekonomik me shumicë dhe pakicë, është i lirë t'i tregtojë këto nënprodukte me çmime më të ulëta se çmimet tavan/maksimale të miratuara nga Bordi.

8. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 30.5.2026, ora 13:00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe gazit, në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

9. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, ministrisë përgjegjëse për ekonominë, ministrisë përgjegjëse për financat, administratës doganore dhe administratës tatimore.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Enea Karakaci, Arjana Dyrmishi, Ilir Binaj, Besmir Beja, Ilia Gjermani, Mariglen Bregu, Sezar Beqaj, Nimet Veliaj, Dritan Basha, Arlind Fida, Klaudio Gega



VENDIM
Nr. 30, datë 2.6.2026

**PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË
TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË
NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE
TË GAZIT**

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 186, datë 19.0.2026, “Për shpalljen e situatës së veçantë në tregun e hidrokarbureve”; në zbatim të nenit 21/3 dhe nenit 21/5 të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar; si dhe të aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, “Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve të naftës, për benzinë të standardit SSHEN 2282018 dhe gazoil të standardit SSHEN 5902018.

2. Vlera “Premio” zbatohet sipas publikimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të një dite më parë.

3. Çmimet e miratuara nga Bordi, të cilat reflektojnë çmimet e nënprodukteve në bursë, të publikuara nga agjencia ndërkombëtare “S&P Global Platts” në USD, në kushtet e livrimit FOB Med, detyrimet doganore/tatimore që aplikohen, si dhe marzhe bruto maksimale të tregtimit (përfshijnë edhe TVSH-në), janë çmime tavan/maksimale në zbatim të metodologjisë së përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

4. Çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve, pas zbatimit të metodologjisë të përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, i ndryshuar, janë si më poshtë:

a) Çmimet tavan (max), për shitjen me shumicë të produkteve:

- 179 lekë/litri për gazoilin;
- 164 lekë/litri për benzinën;

b) Çmimet tavan (max), për shitjen me pakicë të produkteve:

- 191 lekë/litri për gazoilin;
- 176 lekë/litri për benzinën;

c) Çmimet tavan (max), për shitjen e gazoilit për peshkim:

- 96 lekë/litri për gazoilin për peshkim.

5. Referuar aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, “Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ku është parashikuar, se në rast se çmimi i shitjes me pakicë, për gazoil është më i lartë se 220 lekë/litri, apo për benzinën është më i lartë se 200 lekë/litri, zbatohet niveli 80% i akcizës. Bazuar në zbatimin e metodologjisë, sipas pikës 4 të këtij vendimi, çmimet janë nën kufirin e aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, dhe për rrjedhojë niveli i akcizës do të zbatohet i plotë, 100%.

6. Ngarkohet administrata doganore të bëjë zbatimin në sistem të nivelit të plotë të akcizës për produktin gazoil, sipas kodit të NKM-së: 27101944 me 39.376230 lekë/litri, dhe për produktin benzinë, sipas kodeve të NKM-së: 27101245 dhe 27101249 me 39.376230 lekë/litri.

7. Asnjë operator ekonomik nuk mund t'i tregtojë këto nënprodukte mbi çmimet tavan të vendimit të Bordit. Çdo operator ekonomik me shumicë dhe me pakicë është i lirë t'i tregtojë këto nënprodukte me çmime më të ulëta se çmimet tavan/maksimale të miratuara nga Bordi.

8. Efektet e këtij vendimi fillojnë në datë 2.6.2026, ora 15:00, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe të gazit, në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

9. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, ministrisë përgjegjëse për ekonominë, ministrisë përgjegjëse për financat, administratës doganore dhe administratës tatimore.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Enea Karakaci, Arjana Dyrmishi, Ilir Binaj, Besmir Beja, Ilia Gjermani, Mariglen Bregu, Sezar Beqaj, Nimet Veliaj, Dritan Basha, Arlind Fida, Klaudio Gega



VENDIM
Nr. 31, datë 4.6.2026

**PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TAVAN TË
TREGTIMIT ME SHUMICË/PAKICË TË
NËNPRODUKTEVE TË NAFTËS DHE
TË GAZIT**

Bordi i Transparencës dhe Kufizimit të Përkohshëm të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të Nënprodukteve të Naftës dhe të Gazit, në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 186, datë 19.3.2026, “Për shpalljen e situatës së veçantë në tregun e hidrokarbureve”; në zbatim të nenit 21/3 dhe nenit 21/5 të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar; si dhe të aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, “Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’” të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve të naftës, për benzinë të standardit SSHEN 2282018 dhe gazoil të standardit SSHEN 5902018.

2. Vlera “Premio” zbatohet sipas publikimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të një dite më parë.

3. Çmimet e miratuara nga Bordi, të cilat reflektojnë çmimet e nënprodukteve në Bursë, të publikuara nga agjencia ndërkombëtare “S&P Global Platts” në USD, në kushtet e livrimit FOB Med, detyrimet doganore/tatimore që aplikohen, si dhe marzhe bruto maksimale të tregtimit (përfshijnë edhe TVSH-në), janë çmime tavan/maksimale në zbatim të metodologjisë së përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

4. Çmimet tavan/maksimale të tregtimit me shumicë dhe pakicë të nënprodukteve, pas zbatimit të metodologjisë të përcaktuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, i ndryshuar, janë si më poshtë:

a) Çmimet tavan (max), për shitjen me shumicë të produkteve:

- 183 lekë/litri për gazoilin;
- 163 lekë/litri për benzinën.

b) Çmimet tavan (max), për shitjen me pakicë të produkteve:

- 195 lekë/litri për gazoilin;
- 175 lekë/litri për benzinën.

c) Çmimet tavan (max), për shitjen e gazoilit për peshkim:

- 100 lekë/litri për gazoilin për peshkim.

5. Referuar aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, “Për një shtesë në ligjin nr. 61/2012, ‘Për akcizat në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar, ku është parashikuar, se në rast se çmimi i shitjes me pakicë, për gazoil është më i lartë se 220 lekë/litri, apo për benzinën është më i lartë se 200 lekë/litri, zbatohet niveli 80% i akcizës. Bazuar në zbatimin e metodologjisë sipas pikës 4 të këtij vendimi, çmimet janë nën kufirin e aktit normativ nr. 1, datë 3.4.2026, dhe për rrjedhojë niveli i akcizës do të zbatohet i plotë, 100%.

6. Ngarkohet administrata doganore të bëjë zbatimin në sistem të nivelit të plotë të akcizës për produktin gazoil, sipas kodit të NKM-së: 27101944 me 39.376230 lekë/litri, dhe për produktin benzinë, sipas kodeve të NKM-së: 27101245 dhe 27101249 me 39.376230 lekë/litri.

7. Asnjë operator ekonomik nuk mund t'i tregtojë këto nënprodukte mbi çmimet tavan të vendimit të Bordit. Çdo operator ekonomik me shumicë dhe pakicë, është i lirë t'i tregtojë këto nënprodukte me çmime më të ulëta se çmimet tavan/maksimale të miratuara nga Bordi.

8. Efektet e këtij vendimi fillojnë më datë 4.6.2026, ora 15:30, deri në një njoftim të dytë të marrë në mbledhjen e radhës. Ky vendim është i detyrueshëm për të gjitha shoqëritë që tregtojnë me shumicë/pakicë produktet dhe nënproduktet e naftës dhe të gazit, në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar.

9. Ky vendim të publikohet në Fletoren Zyrtare, si dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet, ministrisë përgjegjëse për ekonominë, ministrisë përgjegjëse për financat, administratës doganore dhe administratës tatimore.

Kryetare: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Enea Karakaci, Arjana Dyrmishi, Ilir Binaj, Besmir Beja, Ilia Gjermani, Mariglen Bregu, Sezar Beqaj, Nimet Veliaj, Dritan Basha, Arlind Fida, Klaudio Gega



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë



[[FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË]]Vulosur elektronikisht nga Qendra e
Botimeve Zyrtare|Viti: 2026 - Numri: 116|Datë: 05.06.2026 13:48:29
+02:00|6544c0ff-d670-4312-b25c-8bd7a530a62f

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik(Qendra e
Botimeve Zyrtare)